



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:266830

Datë: 15.01.2020

Numri i dokumentit: 00763202

DKR. P.nr. 01/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE- Departamenti për krime të Rënda në Pejë, Kryetari i trupit gjykues – Gjyqtari, Sylë Lokaj dhe gjyqtaret Sejdi Blakaj e Ahmet Rj anëtar të trupit gjykues e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Binake Mulliqi sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, PP /I.nr.59/2019 , dt 14.11.2019, kundër të akuzuarit B P e për vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së të akuzuarit I H për vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPK , dhe të akuzuarit A R për vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPK ,pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë, verbal e publik në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ardian Hajkdaraj, të akuzuarve B P mbrojtësit Av.Adem Nikqi, I H mbrojtësit Av. Taulant Broqi dhe A R mbrojtësi Av. Vegim Maloku , me dt. **08.01.2020** mur dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Te akuzuarve :

1. B P i biri i R dhe miradijes e gjinisë TH, i lindur me ... në G K. Klinë, ID ..., ka të kryer shkollën e mesme i pa punë, i martuar baba i tre fëmive, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës, i gjykuar më parë, e ka vuajte dënimin, tani ndodhet në paraburgim sipas Aktvendimit të fundit DKR. P.nr. 77/2019.
2. I H i biri N dhe M e gjinisë D, i lindur me 01.07.1971 në fsh.G K, Klinë ku edhe tani banon, ID ... , ka të kryer shkollën fillore, i pa punë i martuar baba i 6 fëmive , Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës,i gjykuar më parë e ka vuajte dënimin, tani ndodhet në paraburgim sipas Aktvendimit të fundit DKR. DKR.P.nr. 77/2019
3. A R i biri , A dhe T e gjinisë H, i lindur me 11.01.1976 në fsh. V K, F ku edhe tani banon, ID ... , ka të kryer shkollën fillore, i pa punë i martuar baba i 2 fëmive , Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës, i gjykuar më parë e ka vuajte dënimin, tani ndodhet në paraburgim sipas Aktvendimit të fundit DKR. DKR.P.nr. 77/2019

JANË FAJTOR

I

I akuzuari B P

- Për shkak se :

Gjatë periudhës kohore prej dt.17.11.2018, e gjere me dt.31.01.2019, ne fshatin Kjevë K. Klinë, pa autorizim ka shpërndarë dhe shitë substanca narkotike te llojit “M “, në sasi te ndryshme , ne atë mënyrë qe pasi qe kanë komunikua për mes telefonit me numër 0... ne shfrytëzim te pandehurit B P në tel.nr....., me këtu dëshmitarin F SH te njëjtit janë marrë vesh dhe janë takuar ne vendin e lartcekur , e ku aty shkon edhe i pandehuri Ilir, ia jep narkotikun dëshmitarit ,duke ia shitë për shumen prej pesë (5) dhe dhjetë (10) euro .

- me çka ka krye veprë penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve , substancave psiko-trope dhe analoge nenin 273 par.2 të ish KPRK-së.

II.

I akuzuari I H:

Për shkak se:

Ne periudhën kohore nga data 18.01.2019, e gjer me dt.15.03.2019, në Klinë , pa autorizim ka shpërndarë dhe shitur substancë narkotike te llojit “ Kokain dhe Marihuanë”, në atë mënyrë qe pasi ka kontaktuar me telefonin e tij me numër 049-149-991, me këtu dëshmitarin A RR ne telefonin me numër 049-129-171, fillimisht me dt.18.01.2019, dëshmitari A ka shkuar ne shtëpinë e te pandehurit dhe ka marre një sasi te pa njohur gjere me tani te llojit “ Marihuanë “, gjersa me dt.15.03.2019, janë takuar ne fshatin K, pikërisht tek një pik e karburanteve , me çrastë aty i pandehuri ia shet dëshmitarit A, narkotikun e llojit “ Kokainë”, ne peshe prej një (1) gram, për shumën prej 50 euro.

- me çka ka krye veprë penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve , substancave psiko-trope dhe analoge nenin 273 par.2 të ish KPRK-së.

III.

I akuzuari A Rj:

Për shkak se:

Me parë e gjëri me datën 18.01.2019, ne qytetet e ndryshme të Kosovës, e pikërisht ne Ferizaj pa autorizim ka shpërndarë dhe shitur substancë narkotike te llojit “ K , në atë mënyrë qe me parë i pandehuri I ka siguruar përmes kanaleve te ndryshme substanca narkotike ,e pastaj te njëjtin e ka shpërndarë te i pandehuri A R i cili pastaj ka kontaktuar me telefonin e tij me numër ..., me këtu dëshmitaren F R ne telefonin me numër ..., me çrastë dëshmitarja herën e fundit ka shkuar ne shtëpinë e te pandehurit me datën.20.07.2019 , dhe ka ble narkotikun e llojit “K” ne shumë prej 50 euro.

- me çka ka krye veprë penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve , substancave psiko-trope dhe analoge nenin 267 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 2, 3, 7, 38, 42 par.3, 43, 69, 70, 71, 72 par.1 pika 1.4, neni 79 lidhur me nenin 267 par.2 KPK-së nenit 273 par.2 (ish) KPK-së, dhe nenit 326 par.4 dhe

nenit 359, 365, 367 par.1 pika 1.2 te KPPK-së, dhe nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.1 , 2.2 dhe 2.6 te KPPK-së, te akuzuarit i:

G J Y K O N

1.Te akuzuarin B P e gjykon:

-me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej tetë (8) muaj .

Ne dënimin me burg i llogaritet paraburgimi nga dt.30.07.2019, deri me dt.08.01.2020.

-me dënim gjobe në të holla ne shumë prej katërqind (400) euro.

Dënimi me gjobe duhet te ekzekutohet ne afat prej 15 ditësh , e nëse i akuzuari e refuzon apo nuk e ekzekuton dënimin me gjobe , i njëjti do ti zëvendësohet me burgim duke llogaritur 20 euro një ditë burgu.

2.Te akuzuarin I H e gjykon.

- me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj .

Ne dënimin me burg i llogaritet paraburgimi nga dt. 30.07.2019, deri me dt.08.01.2020.

-me dënim gjobe në të holla ne shumë prej katërqind (400) euro.

Dënimi me gjobe duhet te ekzekutohet ne afat prej 15 ditësh , e nëse i akuzuari e refuzon apo nuk e ekzekuton dënimin me gjobe, ai do te zëvendësohet me burg duke llogaritur për çdo dite burgu nga 20 euro.

Në kuptim të nenit 284 par.1 të KPPK-së

a).Urdhërohet konfiskimi i një telefoni S, një telefoni I-PHONE ngjyrë e zezë, dhe shuma e të hollave të gatshme prej njëmijë e katërqinë e dhjetë (1.410,00) ero, ashtu që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, Agjencioni për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar, udhëzohet që ti shesë, e mjetet e fituara nga shitja dhe të hollat e konfiskuara të derdhen në llogarinë e bugjetit të Qeverisë së Kosovës.

b).Urdhërohet që të akuzuarit ti kthehet vetura e tipit C L me targa ... me numër të shasisë ... , një qes i veturës së njëjtë, , certifikata e regjistrimit me numër ..., polisa e sigurimit me numër 007122890, polisa e sigurimit kufitar KS2/110171, e sekuestruar sipas urdhrit UGJK.nr.103/19 dt.07.08.2019.

3..Te akuzuarin A R e gjykon.

- me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej tetë (8) muaj .

Ne dënimin me burg i llogaritet paraburgimi nga dt. 30.07.2019, deri me dt.08.01.2020.

-me dënim gjobe në të holla ne shumë prej katërqind (400) euro.

Dënimi me gjobe duhet te ekzekutohet ne afat prej 15 ditësh , e nëse i akuzuari e refuzon apo nuk e ekzekuton dënimin me gjobe, ai do te zëvendësohet me burg duke llogaritur për çdo dite burgu nga 20 euro.

Në kuptim të nenit 284 par.1 të KPPK-së

Urdhërohet konfiskimi i një telefoni i tipit N, ashtu që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, Agjencioni për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar, udhëzohet që ta shesë, e mjetet e fituara nga shitja, të derdhen në llogarinë e bugjetit të Qeverisë së Kosovës.

4. Te akuzuarit B P , I H dhe A R , se cili veç e veç detyrohen qe gjykatës ne emër te shpenzimeve te procedurës penale te ja paguajnë shumen prej nga 50 euro , ndërsa ne emër te paushallit gjyqësorë shumen prej nga 20 euro, nderkaqë ne emër te kompensimit te viktimave te krimit shumen prej nga 50 euro.

Te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh , pasi qe aktgjykimi te mere formën e prerë .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Renda në Pejë, me aktakuzën PP.I nr.59/19 dt.14.11.2019 i ka akuzua të akuzuarit L Rj , për vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së (kodi i vjetër penal) dhe për vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK-së Ilir P për vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPK-së, B P vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPK-së, I H për vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPK-së, A R për vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së, L M për vepër penale, blerja posedimi shpërndarja, shitja e pa autorizuar i narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPK-së dhe vepër penale mbajtja në pronësi , posedim, kontroll të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPK-së.

Më parë me pëlqimin e palëve në procedurë është veçua procedura penale ndaj të akuzuarve L Rj,dhe Ilir P, e lënda ka marrë numrin DKR.P.nr.80/2019 dhe është marrë Aktgjykimi DKR.P.nr.80/2019 dt. 26.11.2019 e të akuzuarit L Rj,dhe Ilir P, për veprat penale për të cilat janë akuzua janë shpallë fajtor dhe janë gjykua sipas ligjit.

Në shqyrtimin e dytë fillestar, më që të akuzuarit B P , I H dhe A R dhe mbrojtësit e tyre i kanë tërheq kundërshtimet ndaj aktakuzës të paraqitura në shqyrtimin fillestarë dhe kanë propozua që ndaj të pandehurve të B P , I H dhe A R të veçohet procedura penale. Me që i akuzuari L M dhe mbrojtësi i tij e kanë kundërshtua aktakuzën Gjykata me pëlqimin e palëve në procedurë e ka veçua procedurën penale ndaj të akuzuarve B P , I H dhe A R e lënda ka marrë numrin DKR.P.nr.01/2020, e ka mbete për tu gjykua si e veçantë për të akuzuarin L M e lënda mbanë numrin fillestar DKR. P.nr.77/2019.

Gjykata të njëjtën ditë ka formua trupin gjykues dhe ka vazhdua me shqyrtim kryesorë për të akuzuarit B P , I H dhe A R. Në shqyrtim kryesorë, Prokurori i Shtetit Ardian Hajdaraj ka mbete në tersi pranë aktakuzës ku Afikimit të njëjt juridik të veprave penale .

I akuzuari B P , që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbrojtësja e të akuzuarit Av. Adem Nikqi, ka deklarua se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion nga as kush, e pas këshillave të mjaftueshme që i ka pasur me mbrojtjen, pajtohem me pranimin e fajësisë.

I akuzuari I H që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. Taulant Broqi, ka deklarua se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion nga as kush, e pas këshillave të mjaftueshme që i ka pasur me mbrojtjen, pajtohem me pranimin e fajësisë.

I akuzuari A R, që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet.

Mbrojtësja e të akuzuarit Av. Vegim Maloku, ka deklarua se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion nga as kush, e pas këshillave të mjaftueshme që i ka pasur me mbrojtjen, propozoj gjykatës që të ja pranon fajësinë.

Prokurori i Shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve për secilin veq e veq., ai tha se pranimi i fajësisë është i bazuar në provat e aktakuzës.

Meqenëse të akuzuarit B P , I H dhe A R , secili veç e veç ,që në fillim të shqyrtimit kryesorë, në tërësi e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen, e Prokurori i Shtetit, është pajtuar me pranimin e fajësisë , gjykata është bindur se të akuzuarit fajësinë e kanë pranua pa presion nga askush e pas këshillave të mjaftueshme nga mbrojtësit, se ata e ka kuptua natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është i bazuar në provat në shkresa te lëndës, raporti policor dëftesa për konfiskimin e narkotikut, aktakuza nuk përmban asnjë nga shkeljet e qarta ligjore.

Për këtë gjykata ka gjetë se janë plotësuar kërkesat e parapara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, ashtu që në kuptim të nenit 326 par.4 të KPPK-së e ka pranua pranimin fajësisë nga ana e të akuzuarve, për të akuzuarin B P për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së për të akuzuarin I H për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPK , dhe për të akuzuarin A R për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPK ,

Prokurori i shtetit Ardian Hajdaraj ne fjalën përfundimtarë tha :

Me qen se te akuzuarit e kanë pranua fajësinë e pranimi i fajësisë është i bazuar ne në provat e aktakuzës , është provuar që te akuzuarit se cili veç e veç i kanë krye veprat penale për te cilat akuzohen . Andaj i propozoj gjykatës që te akuzuarit se cilin veç e veç ti shpallë fajtor, ti gjykoj ne bazë te ligjit dhe ti detyron ne kompensimin shpenzimeve te procedurës penale,

ndërkaq ndaj te akuzuarve I H dhe A Rj tu shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i sendeve te sekuestruara .

Mbrojtësi i te akuzuarit B P Av. Adem Nikqi ne fjalën përfundimtarë tha: Me qen se i mbrojturin tim , e ka pranua fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, nuk ka dyshim se ai e ka kryer këtë vepër , andaj mbrojtja i propozon gjykatës qe me rastin e vendosjes mbi dënim te aplikoj dispozitat për zbutjen e dënimit ashtu qe te akuzuarit ti merën si rrethana lehtësuese pranimi i fajësisë , qe ne një form e ka bere ne te gjitha fazat e procedurës, pendimi i ti i thellë , gjendja familjare fakti se është mbajtës i 3 fëmijëve te mitur , gjendja tejet e dobët ekonomike. Andaj i propozoj Gjykatës qe ti shqipton një dënim minimal i parapare me ligj , me bindje se do te ndikoj mjaftueshëm ne sjelljet e tij ne te ardhmen .

I akuzuari B P ne fjalën përfundimtarë tha :Ne tersi i bashkëngjitëm fjalës përfundimtarë te dhen nga mbrojtja nuk kame çka te shtoj tjetër .

Mbrojtësi i te akuzuarit I H Av. Taulant Broqi ne fjalën përfundimtarë tha: Me qen se i mbrojturi i im e ka pranuar fajësinë nuk ka dyshim se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I propozoj gjykatës e me rastin e vendosjes mbi dënim , ti aplikoj dispozitat për zbutjen e dënimit te parapare me nenin 76 par.1 pika 1.4 te KPPK-se , ashtu qe te akuzuarit ti shqiptoj një dënim nenë minimumin ligjorë. Ndërkaq bazuar ne faktin se mbrojtja konsideron se sendet e Sekuestruara, vetura e te akuzuarit , nuk është përfituara me vepër penale , i propozoj gjykatës qe pas vlerësimit te dëshmime , propozimi i prokurorit te shtetit për shqiptimin e dënimit plotësues konfiskimin e sendeve te mos pranohet .

I akuzuari I H ne fjalën përfundimtarë tha :Ne tersi i bashkëngjitëm fjalës përfundimtarë te dhen nga mbrojtja nuk kam çka te shtoj tjetër .

Mbrojtësi i te akuzuarit A Rj Av. Vegim Maloku ne fjalën përfundimtarë tha:

Me qen se për te mbrojturin tim është pranuar fajësia, nuk ka dyshim se ai e ka krye veprën penale për ter cilën ai akuzohet. Lidhur për dënimin gjykatës i propozoj qe bazuar ne faktet e konstatuar , pranimi i fajësisë , pendimi i të akuzuarit , gjendja tejet e dobët ekonomike , janë rrethana posaçërisht lehtësuese, ashtu qe propozoj qe me rastin e vendosjes për dënim, të aplikohen dispozitat për zbrujtjen e dënimit te parapare me nenin 76 par.1 pika 1. 4 te KPPK-se , e i akuzuari t e gjykohet me dënim nënë minimumin ligjorë. Njëherit ne shkresat e lendes nuk ka dëshmi qe e provojnë se sendet e sekuestruar janë te përfituar me vepër penale , i propozoj gjykatës që propozimi i prokurorit te shtetit për konfiskimin e përhershme, mos ta pranon. Njëherit gjykatës i propozoj qe ndaj të pandehurit, te hiqet paraburgimi me që konsideroj se kanë pushua te gjitha kushtet mbi bazën e te cilave me parë është caktuar dhe vazhdua paraburgimi .

I akuzuari A Rj ne falen përfundimtarë tha ;Ne tersi i bashkëngjitëm fjalës përfundimtare te dhen nga mbrojtja nuk kame çka te shtoj tjetër .

Trupi gjykues konstaton se meqë të akuzuarit secili veç e veç e kanë pranua fajësinë, pranimi i fajësisë është i bazuar në provat në shkresat e lëndës, me këtë gjykata vërteton se i akuzuari B P ditën kohen vendin dhe mënyrën e përshkruar në pikën I të dispozitivit ka krye vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së i akuzuari I H ditën kohen vendin dhe mënyrën e përshkruar në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, ka krye vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe

analoge nga neni 273 par.2 të KPK dhe i akuzuari A R , ditën kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, ka krye veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPK –së.. Për këtë gjykata të akuzuarit secilin veç e veç i ka shpallë fajtor dhe penalisht përgjegjës.

Para se të vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese të cilat kishin për të ndikua në llojin dhe lartësinë e dënimit. Për të akuzuarit për secilin veç e veç, si rrethanë rënduese është marrë fakti se ata janë recidivistë të veprave penale.. Si rrethana lehtësuese në raport me të pandehurit, për secilin veç e veç, janë marrë sjellja e të akuzuarve pas kryerjes së veprës penale- bashkëpunimi me organet e ndjekjes, mosha relativisht e re, gjendja ekonomike tejet e dobët e posaçërisht faktin se të akuzuarit që në fillim të shqyrtimit gjyqësor në tërësi e ka pranua fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzua.

Duke marrë parasysh këto rrethana gjykata të akuzuarit secilin veç e veç i ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me që nuk ka pasë dëshmi se vetura e të akuzuarit I H është përfitua me veprën penale e asë që është përdorur në veprën penale, sikur që përcakton neni 283 par. 1 të KPPK-së , gjykata në kuptim të nenit 284 par.1 të KPPK-së ka vendosur si në nën-pikën 4 të dispozitivit të aktgjykimit .

Kështu është vendosur me bindje të thellë se këto dënime janë në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale të kryera dhe të shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve, e që këto dënime do të shërbejnë si preventiv gjenerale e posaçërisht i asaj individuale, të forcimit të moralit të shoqërisë dhe disiplinës qytetare, e që është në pajtueshmëri me kërkesat e popullit, me bindje që edhe me këto dënime, do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 38 të KPK-së.

Vendimi që të akuzuarit të ja kompensojnë gjykatës shpenzimet në formë paushalli është i bazuar në nenin 450 par.2 pika 6 të KPRK-së, ndërsa që vendimi që të akuzuarit të detyrohet që në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shumen prej nga 50 euro, është i bazuar në nenin 39, par. 3, pikat 3.1 dhe 3.2, të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit Nr. 05/L -036 dhe është gjykuar në lartësinë si në dispozitiv, me bindje se të akuzuarit i kanë kushtet për përmbarim.

Nga sa u tha më lartë, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

**U VENDOS NE GJYKATEN THEMELORE – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA NË PEJË, me dt.08.01.2020
DKR. P.nr.01/2020**

Sekretarja Juridike
Binake Mulliqi d.v.

Kryetari i Trupit Gjyqësor - Gjyqtari
Sylë Lokaj

Anëtarët e trupit gjyqësor-Gjyqtarët
Sami Sharragjiu d.v.
Ahmet Rj d.v.

UDHZIM JURIDIK

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditësh , pas marrje Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.